



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 28.12.2020

Nr: 11

**VENDIM  
PËR**

**CAKTIMIN E RREGULLAVE TË ADMINISTRIMIT DHE SHPËRNDARJES SË  
VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT**

*(ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 19.2.2021)*

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO-	Kryetar
Arens	ÇELA-	Anëtar
Dritan	ÇAKA-	Anëtar
Helga	VUKAJ-	Anëtar
Muharrem	ÇAKAJ-	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 20, pika 1, shkronja "g", dhe 3, neni 103, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Komisioni Rregullator, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmeve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, pika 1, shkronja "g", dhe nenit 103 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

## VËREN:

Referuar nenit 20, pika 1, shkronja “g”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor.

Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në dispozitat e poshtë cituara parashikon:

Neni 103, pika 1 dhe 2:

1. Në pjesën e pasme, fletët e votimit vulosen me vulën e KQV-së dhe me vulën e kryetarit të KQV-së. Në rast se një nga vulat është dëmtuar ose nxjerrë jashtë qendrës së votimit, KQV-ja pajiset menjëherë me vulë rezervë për zëvendësimin e vulës së nxjerrë nga përdorimi. Rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë përcaktohen me akt normativ të KQZ-së. Fakti i nxjerrjes së vulës nga përdorimi shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së bashkë me orën përkatëse. Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë qendrës së votimit përbën veprë penale dhe ndëshkohet sipas nenit 326/a, të Kodit Penal.
2. Vula e KQV-së përmban tekstin “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit. Vula e Kryetarit të KQV-së përmban tekstin “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror. Teksti i vulës rezervë përcaktohet nga KQZ-ja dhe është unik për secilën vulë”.

Neni 160, pika 1, shkronja “c”:

"KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë”.

Neni 117, pika 3, shkronja “b”:

"Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi”.

Referuar parashikimeve të nenit 326/a të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i vulave, është konsideruar nga ligjvënësi veprë penale, duke parashikuar dhe dënimin me burgim nga (6) gjashtë muaj deri në 5 (pesë) vjet. Klasifikimi veprë penale i këtyre veprimeve, tregon se legjislatori ka dashur ta mbrojë në mënyrë të posaçme vulat që përdoren për administrim zgjedhor. Më tej, kjo dispozitë e Kodit Penal i jep rëndësi të veçantë kryerjes së kësaj veprë penale nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor, në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në

mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, duke parashikuar për ta dënimin me burgim nga 3 (tre) deri në 8 (tetë) vjet.

Referuar parashikimeve të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor materialet zgjedhore të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi nën juridiksion. Neni 100, përcakton afatet dhe procedurat për shpërndarjen e materialeve zgjedhore nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor tek Komisioni i Qendrës së Votimit nën juridiksionin e saj. Në këto dy dispozita, materialet zgjedhore të përcaktuara në mënyrë shteruese, nuk përfshijnë në mënyrë të cituar vulat rezervë për komisionet e qendrave të votimit.

Dispozitat e sipërcituara, detyrojnë që rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulate rezervë të realizojnë përmbushjen e urdhërimeve ligjore duke garantuar:

- përgjegjësinë dhe mënyrën për administrimin dhe shpërndarjen e vulate rezervë me një regjim që shmang gabime në shpërndarjen e tyre, si dhe shmang mundësi për keqpërdorim të tyre;
- dokumentimin në detaje nga administrata zgjedhore të rasteve të dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vullës së KQV-së, apo të Kryetarit të KQV-së, dhe njoftimin e menjëhershëm të rastit;
- shpërndarjen e menjëhershme të vullës rezervë për zëvendësimin e vullës së nxjerrë nga përdorimi.

Vula rezervë, si material zgjedhor i rëndësisë së veçantë për shmangien e problemeve të cilat mund të çojnë në pavlefshmëri të zgjedhjeve në një apo disa qendra votimi, apo për shmangien e shkaqeve të pavlefshmërisë së votës, duhet të jetë e administruar për çdo qendër votimi. Administrimi i vulate rezervë në numër të barabartë me numrin e qendrave të votimit në rang vendi, ndjek të njëjtin rregullim ligjor të parashikuar për vullën e Komisionit të Qendrës së Votimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sikundër është vepruar në proceset zgjedhore të mëparshme, do të administrojë vulat rezervë të Komisioneve të Qendrave të Votimit përmes punonjëseve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ndërtesat/ambientet që do të qëndrojnë nëpunësit e autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për të administruar dhe shpërndarë vullën rezervë të Komisioneve të Qendrave të Votimit, do të plotësojnë kriteret ligjore për selitë e KZAZ-ve, të parashikuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor. Lista e nëpunësve që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të autorizojë për të administruar dhe shpërndarë vulat rezervë të Komisioneve të Qendrave të Votimit, adresat e ndërtesave ku ata do të qëndrojnë, do të bëhen menjëherë publike dhe do t'i njoftohen partive politike.

Nxjerrja nga përdorimi i vullës së Komisionit të Qendrës së Votimit, apo i vullës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, për shkak të dëmtimit apo nxjerrjes së saj jashtë qendrës së votimit, dhe zëvendësimi me vullë rezervë do të bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Punonjësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për administrimin dhe shpërndarjen e vulave rezervë të Qendrave të Votimit të zonës zgjedhore/zonës së administrimit zgjedhor përkatëse, është përgjegjës për administrim paraprak e vazhdues të vulës rezervë deri në dorëzimin e saj dhe zbatimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke dorëzuar menjëherë në Qendrën e Votimit përkatëse vulën rezervë për zëvendësim të vulës të nxjerrë jashtë përdorimit, dhe dorëzimin e vulës rezervë tek Komisioni i Qendrës së Votimit me procesverbal të veçantë.

Për të përmbushur kriterin e parashikuar në nenin 103, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, teksti i vulës rezervë do të përmbajë, numrin e qendrës të votimit dhe fjalën "REZERVË", Numri i qendrës së votimit, i përcaktuar sipas sistemit unik të numërimit të qendrave të votimit në rang vendi, realizon kriterin ligjor që secila vulë të ketë tekst unik. Fakti që kjo vulë rezervë do të përdoret nga Komisioni i Qendrës së Votimit vetëm kur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos zëvendësimin e vulës së nxjerrë nga përdorimi me vulë rezervë, specifikohet nga fjala "REZERVË" në tekstin e vulës.

Prodhimi i vulës rezervë me tekst unik për çdo qendër votimi, kryhet në respektim të afateve ligjore sikundër edhe për materialet e tjera zgjedhore. Administrimi i vulave rezervë ditën e votimit në çdo zonë zgjedhore për të gjitha Qendrat e Votimit të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor përkatës, mundësojnë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pavarësisht distancave gjeografike të qendrave të votimit në të gjithë vendin dhe numrit të rasteve, të përmbushë detyrimet ligjore për dorëzimin në një kohë të shkurtër të vulës rezervë tek Qendra e Votimit përkatëse, duke shmangur problemet gjatë procesit të votimit në ditën e votimit.

Dokumentimi dhe njoftimi i rastit të dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, apo vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, do të kryhet në detaje dhe menjëherë nga administrata zgjedhore, sipas procedurave të përcaktuara me këtë vendim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Rregullator, bazuar në nenin 20, paragrafët 1, shkronjat "g", dhe 3, dhe nenin 103, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

*(Pika 1 dhe 8, ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 19.2.2021)*

- 1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:*

- a) *Numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi;*  
b) *Formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë.*
2. Nxjerrja jashtë përdorimit e vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, apo e vulës së Kryetarit të Qendrës së Votimit, dhe zëvendësimi i saj me vulë rezervë, bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Vulat rezervë të qendrave të votimit administrohen dhe shpërndahen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes nëpunësve të administratës të KQZ-së të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:
- a) Ndërtesat ku qëndrojnë nëpunësit e administratës të KQZ-së të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
- b) Lista e nëpunësve të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për të administruar dhe shpërndarë vulën rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe adresat e ndërtesave ku ata qëndrojnë, publikohen në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohen partive politike.
4. Në rastet e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, apo të vulës së Kryetarit të Qendrës së Votimit:
- a) Sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit mban procesverbal në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit të Qendrës së Votimit, ku shënon rrethanat dhe orën e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit vulës përkatëse. Procesverbali firmoset nga anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit;
- b) Kryetari, Sekretari apo çdo anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit, njofton menjëherë Sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës për rrethanat, orën e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës, llojin e vulës, dhe kërkon zëvendësimin e saj me vulë rezervë. Njoftimi dhe kërkesa bëhen nëpërmjet telefonit celular, me mesazh zanor ose tekst të shkruar.
5. Sekretari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor:
- a) shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor numrin e qendrës së votimit, orën dhe rrethanat e njoftuara nga Komisioni i Qendrës së Votimit përkatës, llojin e vulës e cila kërkohet të zëvendësohet, emrin dhe pozicionin e anëtarit të Komisionit të Qendrës së Votimit që bëri njoftimin.
- b) njofton menjëherë Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, përmes administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe i paraqet kërkesë për nxjerrjen nga përdorimi të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit ose vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit përkatës, dhe zëvendësimin e saj me vulë rezervë. Kërkesa përmban numrin e Komisionit të Qendrës së Votimit, orën dhe rrethanat e

njoftuara nga Komisioni i Qendrës së Votimit, llojin e vulës që kërkohet të zëvendësohet, numrin serial në rastin e vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, emrin dhe pozicionin e anëtarit të Komisionit të Qendrës së Votimit që njoftoi Komisionin e Zonës të Administrimit Zgjedhor. Kërkesa paraqitet me shkrim, firmoset nga Sekretari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, dhe sipas rastit nga Kryetari dhe/ose Zv. Kryetari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, vulozet me vulën e Komisionin e Zonës të Administrimit Zgjedhor dhe dërgohet përmes rrugëve elektronike të komunikimit.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

- a) pas administrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të njoftimit/kërkesës të Sekretarit të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, merr vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës të Komisionit të Qendrës së Votimit, apo të Kryetarit të Qendrës së Votimit përkatës, dhe zëvendësimit të saj me vulë rezervë. Në vendim përcaktohet ora e marrjes së vendimit, numri i Qendrës së Votimit, teksti i vulës që nxirret nga përdorimi, dhe teksti i vulës rezervë që zëvendëson vulën e nxjerrë nga përdorimi;
- b) në rrugë elektronike të komunikimit, nëpërmjet administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dërgon menjëherë kopje të vendimit sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi te:
  - i. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës i cili ka nën juridiksion Qendrën e Votimit ku do të zëvendësohet vula e nxjerrë jashtë përdorimit me vulë rezervë;
  - ii. Nëpunësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për administrimin dhe shpërndarjen e vulave rezervë në qarkun ku përfshihet Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor /Komisioni i Qendrës së Votimit përkatës.

7. Administrimi dhe dorëzimi i vulës rezervë në Komisionin e Qendrës së Votimit përkatës ndjek hapat e mëposhtëm:

- a) kryhet me përgjegjësi të plotë nga punonjësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- b) dorëzimi i vulës rezervë kryhet në mjediset e qendrës së votimit përkatëse, në prani të anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit, dokumentohet në material filmik nëpërmjet kamerës të instaluar në qendrën e votimit, dhe në procesverbalin e veçantë, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur;
- c) nëpunësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve njofton menjëherë Komisionin e Zonës të Administrimit Zgjedhor dhe Komisionerin Shtetëror të

- Zgjedhjeve për orën e dorëzimit të vulës rezervë në Komisionin e Qendrës së Votimit përkatës;
- ç) Sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit të Qendrës së Votimit orën e marrjes në dorëzim të vulës rezervë dhe nëpunësin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që kreu dorëzimin;
- d) Vula e dëmtuar merret në dorëzim nga nëpunësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe asgjësohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
8. Në rast se njoftimi sipas paragrafit 4, të këtij vendimi, bëhet për vulën e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe për vulën e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit të së njëjtës qendër votimi, atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:
- a) pas administrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të njoftimit/kërkesës të Sekretarit të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, merr vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe të vulës së Kryetarit të Qendrës së Votimit përkatëse, dhe zëvendësimin e tyre me vula rezervë:
- i. vula e Komisionit të Qendrës së Votimit e nxjerrë jashtë përdorimit zëvendësohet me vulën rezervë, me tekst unik të asaj qendre votimi;
  - ii. vula e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit e nxjerrë jashtë përdorimit zëvendësohet me vulën rezervë, me tekst unik të njëjës nga Qendrat e Votimit të asaj zone të administrimit zgjedhor;
- b) Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas shkronjës “a”, të këtij paragrafi përcakton numrin e qendrës së votimit, tekstin e secilës vulë që nxirret nga përdorimi, dhe tekstin e secilës vulë rezervë që zëvendëson vulat e nxjerra nga përdorimi.
9. Në rastet e dëmtimit të qëllimshëm, ose nxjerrjes jashtë Qendrës së Votimit të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit apo vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referon materialin kallëzues pranë organit të prokurorisë kompetente.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Iirjana NANO-**

**Kryetare**

**Arens ÇELA-**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA-**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ-**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ-**

**Anëtar**

